

VENDIM
Nr. 332, datë 13.5.2026

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 782, DATË 7.10.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E MODELEVE TË AKTEVE KADASTRALE
DHE TË DHËNAVE NË PËRMBAJTJE TË HARTËS KADASTRALE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 5, 15, pika 3, e 17, pika 7, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 782, datë 7.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 4, të kreut II “Modeli dhe përmbajtja e kartelës së pasurisë së paluajtshme”, shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Përfshihet për pasuritë e paluajtshme të digjitalizuara, për shërbimet kadastrale që gjenerohen në mënyrë automatike nga baza shtetërore e të dhënave kadastrale dhe të ofruara përmes shërbimit elektronik publik, në përputhje me legjislacionin që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara dhe dokumentin elektronik, kartela kadastrale lëshohet me vulë elektronike të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, sipas aneksit 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Ky dokument ka të njëjtën vlerë ligjore dhe fuqi provuese si çdo dokument tjetër zyrtar.”.

2. Pas pikës 10, të kreut III “Harta kadastrale dhe modeli i planit të rievimit”, shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:

“10/1. Përfshihet për pasuritë e paluajtshme të digjitalizuara, për shërbimet kadastrale që gjenerohen në mënyrë automatike nga baza shtetërore e të dhënave kadastrale dhe të ofruara përmes shërbimit elektronik publik, në përputhje me legjislacionin që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara dhe dokumentin elektronik, harta kadastrale gjenerohet me vulë elektronike, sipas aneksit 3/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Ky dokument ka të njëjtën vlerë ligjore dhe fuqi provuese si çdo dokument tjetër zyrtar.”.

3. Pas anekseve 1 dhe 3 shtohen përkatësisht anekset me numrat 1/1 dhe 3/1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

II. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Kodi unik _____
(nga _____, në _____)

A-TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale nr _____, Lloji i Pasurisë: _____, Nr i Pasurisë _____, Sipërfaqja totale _____ m²,
(ngate cilat truall _____ m², ndërtesë _____ m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale _____, Numri i pemëve: _____

Adresa e pasurisë: Bashkia _____ Rruga _____ Ndërtesa nr _____ SH/K _____ Apartamenti nr _____

Vlera e pasurisë: _____

Fillestare _____ Lekë (akti nr _____ dt _____) Rrëmbësim _____ Lekë (akti nr _____ dt _____)

B-TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronarit: _____ Nr identifikimi/NIPT _____, Pjesa takuese ____/____
Emër _____ Atësi _____ Mbiemër _____

...vijon

Adresa e pronarit: Bashkia _____ Rruga _____ Ndërtesa nr _____ SH/K _____ Apartamenti nr _____

Akti i fitimit të pronësisë: Emërtimi: _____ Nr _____ Datë: _____

Regjistruar nr _____ Datë: _____

**Pjesëmarrës në bashkëpronësi të detyrueshme për pasurinë nr _____, me kod unik _____*

B/1-TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti paraparak i fitimit të pronësisë: Emërtimi: _____ Nr _____ Datë: _____

Përshkrimi i objektit të aktit: _____

Regjistruar nr _____ Datë: _____

C-TË DREJTAT REALE

Nr. regjistrimi	Dt. regjistrimi	Lloji i të drejtës	Të dhënat e aktit			Afati i vlefshmërisë	Përfutjes	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. identifikim / NIPT

D-KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. regjistrimi	Dt. regjistrimi	Lloji i kufizimit	Të dhënat e aktit			Afati i kufizimit	Përfutjes/Kërkuar	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. identifikim / NIPT

E-INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i informacionit _____ Emërtimi aktit: _____ Nr _____ Datë _____

Regjistruar nr _____ Datë: _____

F-VEPRIMET ME KARTELEN E PASURISË

Veprimet me kartelën kryer nga _____ Veprimi me nr regjistrimi _____ Datë _____

Specialist

Vulesur elektronikisht nga Drejtoria

Vendore XXXX

Date: ZZZZ/YY/XX 00:00:00 +00'00'

XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXX

Shënim: Ky dokument është generuar dhe vulesur me anë të një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shëtitore e Kadastrës)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA SHETERORE E KADASTRES


FRAGMENT I HARTES KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: _____

KODI UNIK: _____

NUMRI PASURISE : _____

INDEX I HARTES: _____



Vulesur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore XXXX
Data: 22/22/YY/JX 00:00:00 - 00:00
XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXX

Shënim : Ky dokument është garantuar dhe vërtetuar me anë
të një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

SHPIJEGUES

PARCELA
NDERTESA